

TREGU ↓ PUNĒS

LABOUR MARKET



20
25

TREGU I PUNËS 2025

LABOUR MARKET

TREGU I PUNËS 2025

LABOUR MARKET 2025

Drejtor botimi/Director of the Publication:
Dr. Lantona Sado

Punoi/Prepared by:

Elona Sevrani
Albana Berbiu
Julinda Haçkaj
Ardita Çaushi
Eva Billa
Brikena Bodi

© *Copyright INSTAT 2026*

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

No part of this publication can be reproduced or transmitted in any form or by any means without the prior written permission of the copyright holder.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

*Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 2233356 / 2222411 4 355
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al*

PËRMBAJTJA

CONTENTS

HYRJE <i>INTRODUCTION</i>	9
GJETJET KRYESORE <i>Main Findings</i>	11
KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË TREGUT TË PUNËS NË SHQIPËRI <i>General characteristics of the labour market in Albania</i>	14
PUNËSIMI <i>Employment</i>	14
PAPUNËSIA <i>Unemployment</i>	17
POPULLSIA EKONOMIKISHT JO-AKTIVE (JASHTË FORCAVE TË PUNËS) <i>Economically inactive population (outside the labour market)</i>	20
TË RINJTË JO NË PUNËSIM E AS DUKE NDJEKUR SHKOLLËN APO NDOJË TRAJNIM <i>Youth neither in employment nor in education or training</i>	22
TREGUES SIPAS QARQEVE <i>Indicators by prefectures</i>	23
STRUKTURA E PUNËSIMIT <i>Employment structure</i>	23
PAGAT <i>Wages</i>	25

Tab 1.1: Forca e punës sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Labour force by education, age and sex</i>	29
Tab 1.2: Punësimi sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Employment by education, age and sex</i>	30
Tab 1.3: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Labour force participation rate by education, age and sex</i>	31
Tab 1.4: Shkalla e punësimit sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Employment rate by education, age and sex</i>	32
Tab 1.5: Përqindja e të punësuarve me pagë në punësimin gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Share of employees in total employment by education, age and sex</i>	33
Tab 1.6: Përqindja e të vetë-punësuarve në punësimin gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Share of self-employment in total employment by education, age and sex</i>	34
Tab 1.7: Përqindja e të punësuarve si punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes në punësimin gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Share of contributing family workers in total employment by education, age and sex</i>	35
Tab 1.8: Struktura e punësimit sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik (sipas NVE Rev.2) <i>Employment structure by sex and economic activity (according to NACE Rev.2)</i>	36
Tab 1.9: Struktura e punësimit sipas gjinisë dhe profesionit (sipas ISCO-08) <i>Employment structure by sex and occupation (according to ISCO-08)</i>	37
Tab 1.10: Punësimi sipas gjinisë dhe orëve aktuale të punës në javë <i>Employment by sex and weekly hours actually worked</i>	38
Tab 1.11: Orët mesatare aktuale javore të punës sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik <i>Mean weekly hours actually worked per employed person by sex and economic activity</i>	39
Tab 1.12: Orët mesatare aktuale javore të punës për të punësuarit me pagë sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik <i>Mean weekly hours actually worked per employee by sex and economic activity</i>	40
Tab 1.13: Përqindja e të punësuarve me pagë me kontratë të përkohshme ndaj të punësuarve me pagë gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Share of temporary employees to total employees by education, age and sex</i>	41
Tab 1.14: Përqindja e të punësuarve me kohë të pjesëshme ndaj të punësuarve gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Share of part time employment to total employment by education, age and sex</i>	42
Tab 1.15: Popullsia në moshë pune sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Working age population by education, age and sex</i>	43
Tab 1.16: Popullsia ekonomikisht jo aktive sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Economically inactive population by education, age and sex</i>	44
Tab 2.1: Papunësia sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Unemployment by education, age and sex</i>	45
Tab 2.2: Shkalla e papunësisë sipas arsimit, moshës dhe gjinisë <i>Unemployment rate by education, age and sex</i>	46

Tab 2.3: Papunësia afatgjatë sipas arsimit, moshës dhe gjinisë	47
<i>Long term unemployment by education, age and sex</i>	
Tab 2.4: Shkalla e papunësisë afatgjatë sipas arsimit, moshës dhe gjinisë	48
<i>Long term unemployment rate by education, age and sex</i>	
Tab 2.5: Përqindja e të papunëve afatgjatë në papunësinë gjithsej sipas arsimit, moshës dhe gjinisë	49
<i>Share of long term unemployed to total unemployment by education, age and sex</i>	
Tab 3.1: Forca e punës sipas qarqeve dhe gjinisë	50
<i>Labour Force by prefectures and sex</i>	
Tab 3.2: Punësimi sipas qarqeve dhe gjinisë	50
<i>Employment by prefectures and sex</i>	
Tab 3.3: Punësimi sipas qarqeve dhe sektorëve kryesorë të ekonomisë	51
<i>Employment by prefectures and main economic activities</i>	
Tab 3.4: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas qarqeve dhe gjinisë	51
<i>Labour Force participation rate by prefectures and sex</i>	
Tab 3.5: Shkalla e punësimit sipas qarqeve dhe gjinisë	52
<i>Employment rate by prefectures and sex</i>	
Tab 3.6: Popullsia në moshë pune sipas qarqeve dhe gjinisë	52
<i>Working age population by prefectures and sex</i>	
Tab 3.7: Papunësia sipas qarqeve dhe gjinisë	53
<i>Unemployment by prefectures and sex</i>	
Tab 3.8: Shkalla e papunësisë sipas qarqeve dhe gjinisë	53
<i>Unemployment rate by prefectures and sex</i>	
Tab 3.9: Popullsia ekonomikisht jo aktive sipas qarqeve dhe gjinisë	54
<i>Economically inactive population by prefectures and sex</i>	
Tab 4.1: Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike dhe gjinisë	55
<i>Gross average monthly wage per employee by economic activities and sex</i>	
Tab 4.2: Hendeku gjinor në paga sipas aktiviteteve ekonomike	56
<i>Gender pay gap by economic activity</i>	
Tab 4.3: Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas grup-profesioneve dhe gjinisë	57
<i>Gross average monthly wage per employee by group of occupations and sex</i>	
Tab 4.4: Hendeku gjinor në paga sipas grup-profesioneve	58
<i>Gender pay gap by group of occupations</i>	
Tab 4.5: Shpërndarja e kontribuesve të punësuar me pagë sipas grupimeve të pagës mesatare mujore bruto dhe gjinisë	59
<i>Distribution of employee contributors by average monthly gross wage intervals and sex</i>	
III. Shënime metodologjike	60
<i>Methodological note</i>	
Tab A1: Devijimet standarde të përgjithshme të zgjedhjes për treguesit kryesorë të tregut të punës	61
<i>Generalised sampling standard deviations for the main labour market indicators</i>	

HYRJE

Statistikat e tregut të punës në Shqipëri përbëjnë një nga instrumentet bazë për analizën e ecurisë së ekonomisë në vend. Prodhimi i këtyre statistikave mbështetet në dy burime kryesore, vrojtime statistikore dhe të dhënat nga burime administrative.

Anketa e Forcave të Punës (AFP) është një vërtetim statistikor i vazhdueshëm, i cili mbledh informacion cilësor dhe sasior për vlerësimin e treguesve kryesorë të tregut të punës, për të gjithë individët 15 vjeç e lart, në Shqipëri. AFP mundëson jo vetëm marrjen e vlerësimeve për një gamë të gjerë treguesish të ofertës për punë, të disagreguar sipas gjinisë dhe arsimit, por përdoret gjithashtu gjerësisht për hartimin e politikave dhe strategjive të punësimit, në nivel kombëtar dhe për grupe specifike të popullsisë.

Në këtë publikim, përveç të dhënave të vlerësuara nga rezultatet e AFP, janë përdorur dhe të dhëna të siguruar nga burimet administrative. Treguesit e llogaritur me të dhënat administrative janë paga mesatare mujore bruto, detajuar sipas gjinisë, aktiviteteve ekonomike dhe profesioneve.

Ky publikim përbëhet nga dy kapituj kryesorë. Në Kapitullin e parë trajtohen karakteristikat e përgjithshme të tregut të punës, ku përfshihen punësimi, papunësia, popullsia ekonomikisht jo-aktive dhe të rinjtë që nuk janë në punësim, e as duke ndjekur shkollën apo ndonjë trajnim.

Në Kapitullin e dytë trajtohen struktura e punësimit sipas qarqeve dhe sektorëve të ekonomisë dhe pagat.

INTRODUCTION

Labour market statistics in Albania constitute a basic instrument for analysing the performance of the economy in the country. The production of these statistics is based on two main sources, statistical surveys and administrative data.

The Labour Force Survey (LFS) is a continuous statistical survey that collects qualitative and quantitative information to assess key labour market indicators, for all individuals aged 15 and over in Albania. LFS enables not only the availability of estimations for a wide range of gender- and education-disaggregated indicators of labour supply, but is also widely used to develop policies and employment strategies at national level and for specific population groups.

In this publication, besides the data evaluated according to LFS, also data from administrative sources are used. Indicators calculated with administrative data are the average gross monthly wage, disaggregated by gender, economic activity group and occupation group.

This publication consists of two main chapters. The first Chapter deals with the general characteristics of the labour market, including employment, unemployment, the economically inactive population and young people not in employment nor in education or training.

The second chapter deals with the employment structure by regions and sectors of the economy, and wages.

GJETJET KRYESORE

- Gjatë vitit 2025, forca e punës vlerësohet të jetë 1.279.906 persona, ku meshkujt përbëjnë 54,2% të forcës së punës, ndërsa femrat 45,8%.
- Të punësuar vlerësohen të jenë 1.172.359 persona, ku meshkujt përbëjnë 54,8% të të punësuarve dhe femrat 45,2%.
- Të papunë vlerësohen të jenë 107.548 persona, ndër të cilët 47,3% janë meshkuj dhe 52,7% janë femra.
- Shkalla zyrtare e papunësisë për grupmoshën mbi 15 vjeç është 8,4%. Për meshkujt, shkalla zyrtare e papunësisë është 7,3%, ndërsa për femrat është 9,7%.
- Për grupmoshën 15-64 vjeç; shkalla e papunësisë është 9,3%; duke shënuar një rënie prej 0,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2024. Për meshkujt, shkalla e papunësisë është 2,4 pikë përqindje më e ulët sesa për femrat.
- 69,3% e popullsisë 15-64 vjeç¹ është e punësuar, 9,3% është e papunë dhe 23,7% është ekonomikisht jo aktive (jashtë forcave të punës).
- 76,0% e meshkujve 15-64 vjeç janë të punësuar, 8,2% janë të papunë dhe 17,3% janë jashtë forcave të punës.
- 62,7% e femrave 15-64 vjeç janë të punësuar, 10,6% janë të papuna dhe 29,9% janë jashtë forcave të punës.
- Paga mesatare mujore bruto, për një të punësuar me pagë, në Shqipëri, është 84.112 lekë, 8,6% më shumë, krahasuar me vitin 2024.
- Hendeku gjinor në paga është 4,6%, cka tregon se meshkujt kanë një pagë mesatare mujore bruto 4,6% më të lartë sesa femrat. Krahasuar me vitin 2024, hendeku gjinor në paga është ulur me 0,3 pikë përqindje.
- 12,6% e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë, marrin një pagë mesatare mujore bruto, deri në nivelin e pagës minimale zyrtare.

¹Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe shkalla e punësimit llogariten për popullsinë e moshës 15 deri në 64 vjeç. Ndërsa shkalla e papunësisë llogaritet për popullsinë ekonomikisht aktive (ndryshe forca e punës) të moshës 15 vjeç e lart. Shkallët e punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcat e punës të llogaritura mbi popullsinë 15 vjeç e lart ndikohen nga përfshirja e personave mbi 65 vjeç në emërues dhe kështu janë më pak kuptimplotë sesa shkallët e llogaritura për popullsinë e moshës 15-64 vjeç. Ndërsa, në llogaritjen e shkallës së papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart, në emërues kemi popullsinë ekonomikisht aktive, e cila përfshin personat e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune dhe të aftë për punë, dhe si rrjedhojë ky tregues nuk ndikohet nga popullsia mbi 65 vjeç.

KEY FINDINGS

- During 2025, the labour force is estimated to be 1,279,906 persons, where males account for 54.2% of the labour force and females 45.8%.
- Employment is estimated at 1,172,359 persons, from which males account for 54.8% and females 45.2%.
- The total number of unemployed persons is estimated at 107,548, of whom 47.3% are men and 52.7% are women.
- In 2025, the official unemployment rate for the population aged 15 year and more is 8.4%. For men the official unemployment rate is 7.3%, while for women it is 9.7%.
- For the age group 15–64 years, the unemployment rate is 9.3%, representing a decrease of 0.1 percentage points compared with 2024. The unemployment rate for men is 2.4 percentage points lower than that for women.
- 69.3% of the population aged 15-64 years old¹ is employed, 9.3% is unemployed and 23.7% is economically inactive (outside the labour force).
- 76.0% of male population aged 15-64 years old are employed, 8.2% are unemployed and 17.3% are outside the labour force.
- 62.7% of female population aged 15-64 years old are employed, 10.6% are unemployed and 29.9% are outside the labour force.
- The average gross monthly wage of paid employees in Albania is estimated at 84,112 ALL, which is 8.6% higher than in 2024.
- The gender pay gap is estimated at 4.6%, indicating that the average gross monthly wage of men is 4.6% higher than that of women. Compared with 2024, the gender pay gap has narrowed by 0.3 percentage points.
- 12.6% of contributors of the category of employees receive an average monthly gross wage up to the official minimum wage level.

¹The labour force participation and employment rates are calculated based on the population aged 15 to 64 years while the unemployment rate is calculated based on the economically active population (labour force) aged 15 and over. The employment and labour force participation rates calculated for those aged 15 and over are affected by the inclusion of the population over 65 years of age in the denominator and are therefore less meaningful than the rates calculated for those aged from 15 to 64. However, for calculating the unemployment rate for those aged 15 and over, the denominator is the economically active population which includes people in work or actively seeking and ready to work. Therefore, this indicator is not affected by the population over the 65 years of age.

FIG.1 TREGUESIT E TREGUT TË PUNËS SIPAS GJINISË PËR GRUPMOSHËN 15–64 VJEÇ, 2025
Labour market indicators by sex for the age-group 15-64 years old, 2025





FIG. 2 TREGUESIT E TREGUT TË PUNËS SIPAS GRUPMOSHËS 15–64 VJEÇ, 2024 DHE 2025
Labour market indicators for the age-group 15-64 years old, 2024 and 2025





POPULLSIA NË MOSHË PUNE WORKING AGE POPULATION


15+ vjeç
years old

2024

2.021.467

2025

2.004.966



2024

2025

Të punësuar

1.177.245

1.172.359

Employed

Të punësuar me pagë

537.534

562.828

Employees

Të vetëpunësuar

354.604

361.790

Self-employed

Punëtorë pa pagesë
në biznesin familjar

285.108

248.000

Unpaid family workers

Të papunë

109.854

107.548

Unemployed persons

Ekonomikisht joaktivë

734.368

725.060

Economically inactive

Ekonomikisht aktivë

1.287.099

1.279.906

Economically active

KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË TREGUT TË PUNËS NË SHQIPËRI

PUNËSIMI


Gjatë vitit 2025, numri i të punësuarve 15+ në Shqipëri vlerësohet të jetë 1.172.359 persona, duke shënuar një rënie prej 0,4%, krahasuar me vitin paraardhës.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç është 76,3%. Meshkujt paraqesin një nivel më të lartë pjesëmarrjeje në tregun e punës krahasuar me femrat, me një diferencë prej 12,6 pikë përqindje.

Për të njëjtën grupmoshë, shkalla e punësimit është 69,3%. Shkalla e punësimit për femrat është 62,7% dhe për meshkujt 76,0%, duke rezultuar në një hendek gjinor në punësim prej 13,3 pikë përqindje.

Numri i të punësuarve në moshën mbi 65 vjeç, nga 119,862 në 2024 është në 130,274 në 2025. Keta persona edhe pse në moshë pensioni, janë kryesisht të vetëpunësuar në bujqësi jo kontribues, të cilët sipas përkufizimit të ILO-s, konsiderohen të punësuar edhe kur punojnë në fermën e tyre të vogël dhe prodhojnë vetëm për vetë-konsum.

FIG. 3 PUNËSIMI (15+) SIPAS AKTIVITETEVE EKONOMIKE, 2025
Employment (15+) by economic activities, 2025



Sektori i shërbimeve dhe sektori bujqësor kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve, me përkatësisht 48,2% dhe 33,8% të të punësuarve gjithsej.

Analiza e punësimit sipas grup-profesioneve paraqet strukturën e punësimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Në vitin 2025, "punonjësit e kualifikuar" në bujqësi dhe në tregti përbëjnë 45,3% të të punësuarve. Më pas renditen grupet: 'Menaxherë, profesionistë dhe teknikë' dhe 'Nëpunës dhe punonjës të shitjeve dhe shërbi-

GENERAL CHARACTERISTICS OF THE LABOUR MARKET IN ALBANIA

EMPLOYMENT

During 2025, the number of employed persons 15+ in Albania is estimated at 1,172,359, representing a decrease of 0.4% compared with the previous year.

The labour force participation rate for the population aged 15–64 years is estimated at 76.3%. Men have a higher labour market participation rate than women, with a gap of 12.6 percentage points.

The employment rate for the population aged 15-64 years old is 69.3%. The employment rate for women is 62.7%, while for men it is 76.0%, resulting in a gender employment gap of 13.3 percentage points.

The number of employed persons aged 65 years and over increased from 119,862 in 2024 to 130,274 in 2025. Although these individuals are of retirement age, they are predominantly self-employed in agriculture and do not contribute to the social insurance scheme. According to the ILO definition, they are considered employed even when working on their own small farms and producing solely for own consumption.

The service and agricultural sectors have the highest share of employed with respectively 48.2% and 33.8% of the total employment.

Analysis of employment by occupation groups shows the structure of employment in different sectors of the economy.

In 2025, "skilled" agricultural and trades workers account for 45.3% of total employment. Then follow the groups of 'Managers, professionals and technicians' and Clerical, service and sales workers' which

2025

meve, të cilët përbëjnë përkatesisht 22,5% dhe 18,5% të totalit të të punësuarve.


Sipas vlerësimeve të anketës për vitin 2025, rezulton se për popullsinë e moshës 15 vjeç e lart, 48,0% e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 30,9% janë të vetëpunësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 21,1% janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.

TREGU I PUNËS | LABOUR MARKET

account for respectively 22.5% and 18.5% of the employed.

According to 2025 survey estimates, it results that for the population aged 15 year and more 48.0% of employed are paid employees, 30.9% are self-employed (with employees or without employees) and 21.1% are contributing family workers.

FIG. 4 PUNËSIMI (15+) SIPAS STATUSIT NË PUNËSIM, 2024 DHE 2025
Employment (15+) by status in employment, 2024 and 2025



Duke analizuar statusin në punësim nga këndvështrimin gjinor, vihet se femrat kanë rreth dy herë më shumë gjasa sesa meshkujt për të qenë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes. Sipas vlerësimeve të AFP-së, 29,3% e femrave të punësuar dhe 14,4% e meshkujve të punësuar rezultojnë të jenë punëtorë pa pagesë në biznesin familjar.

Analysing employment status from a gender perspective, it is observed that women are about twice as likely as men to be unpaid family workers in a family business. According to LFS estimates, 29.3% of employed women and 14.4% of employed men are unpaid family workers in a family business.

Në vitin 2025, përqindja e punësimit informal në sektorin jo-bujqësor është 21,8%, duke shënuar një rënie prej 2,9 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2024.

In 2025, the share of informal employment in the non-agricultural sector is 21.8%, representing a decrease of 2.9 percentage points compared with 2024.

TË PUNËSUAR EMPLOYED

15-64 vjeç
years old

2024

1.057.383

2025

1.042.085

2024

3,5%

Të vetëpunësuar me të
punësuar kundrejt një page
Self-employed with paid
employees

25,1%

Punëtorë pa pagesë në
biznesin familjar
Unpaid family workers

21,4%

Të vetëpunësuar pa të
punësuar kundrejt një page
Self-employed without paid
employees

50,0%

Të punësuar me pagë
Employees

2025

4,2%

18,2%

25,0%

52,6%

PAPUNËSIA

Gjatë vitit 2025, numri i të papunëve 15+ në Shqipëri është 107.548 persona. Shkalla zyrtare e papunësisë është 8,4% duke shënuar një rënie prej 0,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2024. Sipas gjinisë, shkalla zyrtare e papunësisë është 7,3% për meshkujt dhe 9,7% për femrat.


Shkalla e papunësisë për grupmoshën 15–24 vjeç është 21,5%, duke u ulur me 1,3 pikë përqindje, krahasuar me vitin paraardhës. Personat e papunë prej një viti ose më shumë përbëjnë 72,7% të të papunëve gjithsej, me një ulje prej 3,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin e mëparshëm.

UNEMPLOYMENT

During 2025, the number of unemployed persons 15+ in Albania is estimated at 107,548. The official unemployment rate is 8.4%, representing a decrease of 0.1 percentage points compared with 2024. By gender, the unemployment rate is 7.3% for men and 9.7% for women.

The unemployment rate for the age group 15–24 years is 21.5%, decreasing by 1.3 percentage points compared with the previous year. Persons unemployed for one year or more account for 72.7% of total unemployment, a decline of 3.1 percentage points compared with the previous year.

FIG. 5 SHKALLA E PAPUNËSISË SIPAS GRUP MOSHAVE, 2024-2025
Unemployment rate by age groups, 2024-2025




Duke analizuar shkallën e papunësisë sipas nivelit arsimor në vitin 2025, vihet re se shkalla është më e lartë për personat me arsim të mesëm (9,8%), ndjekur nga ata me arsim 8 / 9 vjeçar (8,5%).

Gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin e kaluar, shkalla e papunësisë ka shënuar ulje për të gjitha nivelet arsimore: për personat me arsim të mesëm me 0,9 pikë përqindje, për personat me arsim të lartë me 0,7 pikë përqindje dhe për personat me arsim 8/9 vjeçar është rritur me 0,9 pikë përqindje.

Analysing of the unemployment rate by educational level in 2025, the unemployment rate is higher among persons with secondary education (9.8%) followed by those with primary education (8.5%).

In 2025, compared with the previous year, the unemployment rate declined across all educational attainment levels: by 0.9 percentage points for persons with secondary education, by 0.7 percentage points for persons with tertiary education, and increased by 0.9 percentage points for persons with primary (8/9-year) education.

FIG.6 SHKALLA E PAPUNËSISË SIPAS NIVELIT ARSIMOR (POPULLSIA 15+), 2024 DHE 2025
Unemployment rate by educational level (population 15+), 2024 and 2025



SHKALLA E PAPUNËSISË SIPAS GJINISË DHE GRUPMOSHAVE UNEMPLOYMENT RATE BY AGE AND SEX

15+ vjeç
years old



Meshkuj
Men

7,3 %

Femra
Women

9,7 %



2024

2025

Mosha:

2025

2024

22,8%

17,7%

15-24

27,4%

22,8%

14,5%

11,8%

25-29

9,3%

16,3%

6,3%

6,0%

30-64

7,2%

7,8%

POPULLSIA EKONOMIKISHT JO-AKTIVE (JASHTË FORCAVE TË PUNËS)

Gjatë vitit 2025, 23,7% e popullsisë së grupmoshës 15-64 vjeç është ekonomikisht jo-aktive. Struktura e popullsisë jashtë forcave të punës dominohet nga nxënësit/studentët, të cilët përbëjnë 41,2% të kësaj kategorie. Në këtë grupmoshë, personat e papunë të dekurajuar, të cilët nuk kërkojnë punë se besojnë se nuk ka punë/vende të disponueshme, përbëjnë 1,2%.

Për meshkujt e moshës 15-64 vjeç ekonomikisht jo-aktivë, 1,9% janë të papunë të dekurajuar, 53,1% janë nxënës/studentë ose në trajnim të mëtejshëm, 3,0% janë në pension ose pension të parakohshëm.

Ndërsa, për femrat e e së njëjtës grupmoshë, 0,8% janë të papunë të dekurajuar, 34,5% janë nxënës/studentë ose në trajnim të mëtejshëm, 15,1% në pension ose pension të parakohshëm dhe 28,1% e tyre janë duke përmbyshur detyrat shtëpiake.

Ndërkohë, grupmosha 65+ përbën pjesën më të madhe të popullsisë ekonomikisht joaktive mbi 15 vjeç, ku me 51% janë Individidë që janë larguar nga popullsia ekonomikisht aktive për shkak të moshës se pensionit.

ECONOMICALLY INACTIVE POPULATION (OUTSIDE THE LABOUR FORCE)


During 2025, 23.7% of the population aged 15-64 years old is economically inactive. The structure of the population outside labour market is dominated by pupils/students (41.2%). In this age-group, 1.2% are not looking for a job because they believe that there are not available jobs.

Among the economically inactive male population aged 15-64 years old, 1.9% are discouraged workers, 53.1% are pupils/students or in further training, 3.0% are in retirement or early retirement.

Among the economically inactive female population aged 15-64 years old, 0.8% are discouraged workers, 34.5% are pupils/students or in further training, 15.1% are in retirement or early retirement, and 28.1% of them are fulfilling domestic tasks.

The population aged 65 years and over represents the largest share of the economically inactive population aged 15 years and over, accounting for 51 percent. This group consists primarily of individuals who are no longer economically active due to retirement.

FIG. 7 STRUKTURA E POPULLSISË 15-64 VJEÇ EKONOMIKISHT JO-AKTIVE SIPAS GJINISË, 2025
Structure of the economically inactive population aged 15-64 years old by sex, 2025



**TRANZICIONI NGA SHKOLLA NË PUNË PËR
TË RINJTË E GRUPMOSHËN 15-29,
2025**

**TRANSITION FROM SCHOOL TO WORK FOR
YOUNG PEOPLE 15-29 YEARS OLD,
2025**



Tranzicion
Transition

7,2%

Në tranzicion
In transition

4,1%

Trazicion nuk ka filluar ende
Transition not started

9,1%

Gjithsej
Total

20,4%

TË RINJTË JO NË PUNËSIM E AS DUKE NDJEKUR SHKOLLËN APO NDOJË TRAJNIM

Në vitin 2025, të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç, të cilët nuk janë të punësuar, nuk janë duke ndjekur shkollën apo ndonjë formim profesional përbëjnë 20,1% të të rinjve gjithsej. Nga këta, 38,5% janë të papunë. Pjesa tjetër e të rinjve janë jashtë tregut të punës për arsye se janë të dekurajuar (1,6%), duke përmbushur detyra dhe përgjegjësi familjare (19,5%), ose për arsye të tjera (40,4%). Krahasuar me vitin paraardhës, të rinjtë e dekurajuar pësuan një ulje prej 0,4 pikë përqindje.


Duke analizuar të rinjtë të cilët nuk janë të punësuar, nuk janë duke ndjekur shkollën apo trajnim profesional sipas gjinisë dhe statusit të tyre në tregun e punës, vihet re se meshkujt janë më aktivë në treg sesa femrat (46,5% e meshkujve janë në kërkim të një pune dhe të gatshëm për të punuar, ndërsa tek femrat kjo përqindje është 31,9%).

YOUTH NEITHER IN EMPLOYMENT NOR IN EDUCATION OR TRAINING

Over the year 2025, youth aged 15-29 years old neither in employment nor in education or training account for 20.1% of all youth population. In this group, 38.5% are unemployed. The other part is outside the labour force because they are discouraged workers (1.6%), fulfilling domestic and family responsibilities (19.5%), or for other reasons (40.4%). Compared to the previous year, the discouraged youth decreased by 0.4 percentage points.

Analysing youth who are neither in employment nor in education or training by sex and their status in the labour market, men are more active than women (46.5% of males are seeking for a job and are available to work, while for females this percentage is 31.9%).

FIG. 8 TË RINJTË (15-29 VJEÇ) JO NË PUNËSIM DHE AS DUKE NDJEKUR SHKOLLËN, SIPAS STATUSIT NË TREGUN E PUNËS, 2025
Youth (15-29) neither in employment nor in education, by labour market status, 2025.



TREGUES SIPAS QARQEVE

INDICATORS BY PREFECTURES

STRUKTURA E PUNËSIMIT

EMPLOYMENT STRUCTURE

Në vitin 2025, qarqet me shkallë punësimi më të lartë janë: Berati (65,3%) dhe Fieri (63,9%), ndërsa qarqet me shkallë punësimi më të ulët janë: Lezha (50,6%) dhe Elbasani (52,9%). Qarqet me shkallë papunësie më të lartë janë: Lezha (17,8%) dhe Elbasani (16,2%), ndërsa qarqet me shkallë papunësie më të ulët janë: Gjirokastra (3,5%) dhe Fieri (4,7%).

Në vitin 2025, në qarkun e Tiranës, sektori i shërbimeve përfshin pjesën më të madhe të të punësuarve gjithsej, me 69,2% të tyre. Në këtë qark 23,5% e të punësuarve janë të punësuar në sektorin e industrisë dhe vetëm 7,3% e tyre punojnë në bujqësi. Në qarkun e Durrësit, 31,6% të të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e industrisë (duke shënuar qarkun me numrin më të madh të punonjësve në këtë sektor), 43,4% në sektorin e shërbimeve dhe 24,9% në sektorin e bujqësisë.


Në qarkun e Lezhës, Vlorës, Shkodrës dhe Gjirokastrës përkatësisht 44,7%, 47,2%, 43,8% dhe 44,8% e të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e shërbimeve, 18,9%, 23,9%, 17,4% dhe 20,3% në sektorin e industrisë dhe 36,5%, 28,9%, 38,8% dhe 34,9% në sektorin e bujqësisë. Në qarqet e tjera të vendit është punësimi në bujqësi ai që zë një peshë të konsiderueshme me 45,2% e më shumë.

In 2025, prefectures with the highest employment rate are: Berat (65.3%) and Fier (63.9%), whereas the prefectures with the lowest employment rate are: Lezhë (50.6%) and Elbasan (52.9%). Prefectures with highest unemployment rate are: Lezhë (17.8%) and Elbasan (16.2%), whereas the prefectures with the lowest unemployment rate are: Gjirokastra (3.5%) dhe Fier (4.7%).

In 2025, in the prefecture of Tirana, services employ the major part of the total employed, 69.2%. In this prefecture, 23.5% of the total employed is in industry and only 7.3% of them are engaged in agriculture activities. The prefecture of Durrës has 31.6% of employed engaged in industry (marking the prefecture with the highest number of employed in the sector), 43.4% in services and 24.9% in agriculture.

In the prefectures of Lezhë, Vlorë, Shkodër dhe Gjirokastrë respectively 44.7%, 47.2%, 43.8% and 44.8% of employed people work in services sector, 18.9%, 23.9%, 17.4% and 20.3% in industry, and 36.5%, 28.9%, 38.8% and 34.9% in agriculture. In the other prefectures of the country, the employment in agriculture prevails with 45.2% or more of the total employment.

FIG. 9 STRUKTURA E PUNËSIMIT SIPAS QARQEVE DHE SEKTORËVE TË EKONOMISË, 2025
Employment structure by prefectures and economic sectors, 2025



TREGUESIT VJETORË SIPAS QARQEVE

ANNUAL INDICATORS BY PREFECTURES

2024

2025



70.9 %
Kukës
66.0 %
Gjirokastrë

Qarqet me shkallë
punësimi më të lartë
Prefectures with higher
employment rate

47.6 %
Lezhë
51.7 %
Vlorë

Qarqet me shkallë
punësimi më të ulët
Prefectures with lower
employment rate

3.0 %
Gjirokastrë
4.7 %
Fier

Qarqet me shkallë
papunësie më të ulët
Prefectures with lower
unemployment rate

13.6 %
Elbasan
17.8 %
Lezhë

Qarqet me shkallë
papunësie më të lartë
Prefectures with higher
unemployment rate

65.3 %
Berat
63.9 %
Fier

50.6 %
Lezhë
52.9 %
Elbasan

3.5 %
Gjirokastrë
3.9 %
Fier

17.8 %
Lezhë
16.2 %
Elbasan



PAGAT

Në vitin 2025, paga mesatare bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 84.112 lekë, duke shënuar një rritje prej 8.6%, krahasuar me vitin 2024.

Paga llogaritet me të dhënat e listë-pagesave të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, dhe mbulon të gjithë sektorët e ekonomisë dhe kontribuesit, shtetas shqiptarë e të huaj, për të cilët ndërmarrja deklaron pagë mujore bruto.

Gjatë vitit 2025, 12,6% e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë marrin një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare. Për vitin 2025, paga minimale zyrtare është 40.000 lekë.


WAGES

In 2025, in Albania, the average monthly gross wage per employee is 84,112 ALL, representing an increase of 8.6% compared with 2024.

This wage is calculated based on the enterprises' payrolls declared to the General Directorate of Taxation for contributions on social security, health and tax on income from employment. It covers all sectors of economy and contributors, Albanian and foreign citizens for whom the enterprise declares a gross monthly wage.

During 2025, 12.6% of employee receives average monthly gross wage up to the level of the official minimum wage. For the year 2025, the official minimum wage is 40,000 ALL.

FIG. 10. SHPËRNDARJA E KONTRIBUESVE TË PUNËSUAR ME PAGË SIPAS GRUPIMEVE TË PAGËS MESATARE MUJORE BRUTO
Distribution of employee contributors by average monthly gross wage intervals



Në vitin 2025, hendeku gjinor në paga është 4,6%. Pra meshkujt kanë një pagë mesatare mujore bruto 4,6% më të lartë sesa femrat. Krahasuar me vitin e mëparshëm hendeku gjinor në paga ka rënë me 0,3 pikë përqindje.

Hendeku gjinor në paga është më i theksuar mes punonjësve që janë të punësuar në ndërmarrjet ekonomike që i përkasin grup-aktivitetit ekonomik "Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit". Për këtë grup-aktivitet, hendeku gjinor në paga është 25,4%.

Paga mesatare mujore bruto është mbi nivelin mesatar kryesisht për grup-aktivitetin ekonomik të "Aktiviteteve Financiare dhe të sigurimit", "Informacionit dhe komunikacionit", si dhe "Administratës publike dhe mbrojtjes; siguri social i detyrueshëm; Arsimi; Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale".

Ndërsa aktivitetet ekonomike me pagë poshtë nivelit mesatar janë kryesisht grup-aktiviteti ekonomik i Tregtisë me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; Transporti dhe magazinimi; aktivitetet e Akomodimit dhe shërbimit ushqimor, grup-aktiviteti ekonomik i Ndërtimit si dhe grup-aktiviteti ekonomik i Bujqësisë, Silvikulturës dhe Peshkimit.

In 2025, the gender pay gap is 4.6%. So, men have average monthly gross wage of 4.6% higher than women. Compared with previous year, the gender pay gap has decreased by 0.3 percentage points.


The gender pay gap is higher among employees who are employed in economic enterprises belonging to the economic activity group "Mining and quarrying; manufacturing; electricity, gas, steam and air conditioning supply; water supply; sewerage, waste management and remediation activities". For this group-activity, the gender pay gap is 25.4%.

The average monthly gross wage is above the national average level, mainly for economic group-activity of Financial and Insurance Activities, for economic group-activity of Information and communication and for economic group-activity of Public administration and defence; compulsory social security; education; human health and social work activities.

While below the national average level is mainly for the economic group-activity of Wholesale and retail trade; repair of motor vehicles and motorcycles; transport and storage; accommodation and food service activities, economic group-activity of industry and economic group-activity of Agriculture, forestry and fishing.

HENDEKU GJINOR NË PAGË

GENDER PAY GAP



Menaxherë, ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë

-8,7%

-11.0%

Managers, Lawmakers, Senior civil servants and Executive directors

Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)

16,0%

14.3%

Professionals

Teknikë dhe specialistë në zbatim

9,9%

9.8%

Technicians and Associate Professionals

Nëpunësit

4,3%

5.0%

Clerical Support Workers

Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve

23,2%

23.6%

Services and Sales Workers

Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit

8,8%

8.9%

Skilled Agricultural, Forestry and Fishery Workers

Zejtare, artizanë dhe profesione të lidhura me to

19,5%

22.5%

Craft and Related Trades Workers

Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve

19,3%

22.8%

Plant and Machine Operators, and Assemblers

Punëtorë (Profesione elementare)

7,2%

8.8%

Elementary Occupations

Forcat e armatosura

-0,2%

0.7%

Armed Forces Occupations

Në vitin 2025, grup-profesionet më të paguara janë: Manaxherët, Ligjvënësit, nëpunësit e lartë të administratës shtetërore dhe drejtorët ekzekutivë; Specialistët me arsim të lartë (profesionistë); dhe Forcat e Armatosura në grup-aktivitetet e Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale.

Ndërsa grup-profesionet më pak të paguara janë: Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit; punëtorët e profesioneve elementare; dhe zejtarët, artizanët dhe profesione të lidhura me to në grup-aktivitetet e Bujqësisë, Silvikulturës dhe Peshkimit, grup-aktivitetit të Industrisë si dhe Tregtisë me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor.

Duke analizuar shpërndarjen e pagës mesatare mujore bruto në Shqipëri, sipas profesioneve dhe aktiviteteve ekonomike, identifikohen sektorët dhe profesionet me nivel të lartë apo të ulët page. Duke ju referuar grafikut të mëposhtëm, vihet re se pjesa më e madhe e të punësuarve përfshihet në intervalin e pagave 60.001 - 95.000 lekë, duke reflektuar dominim të grupit të punonjësve me të ardhura mesatare në tregun e punës.

In 2025, the most paid group-professions are: Managers, Lawmakers, senior civil servants and executive directors; Specialists with higher education (professionals); and Armed Forces Occupations for economic group-activity of Public administration and defence; compulsory social security; education; human health and social work activities.

While the lowest paid occupational groups are group-professions: Qualified employees of forestry and fishing agriculture; workers of professional professions; and craftsmen, artisans and related professions for economic group-activity of Agriculture, forestry and fishing for economic; group-activity of Industry; as well as Wholesale and retail trade; repair of motor vehicles and motorcycles; transportation and storage; accommodation and food service activities.

Analysing the distribution of the average gross monthly wage by occupations and economic activities in Albania, we identify activities and occupations with high or low wages levels. The graph below, shows that most wages fall in the interval of 60,001 - 95,000 ALL, reflecting the dominance of the employees' group with middle-income.

FIG. 11. PAGA MESATARE MUJORE BRUTO SIPAS PROFESIONEVE DHE AKTIVITETEVE EKONOMIKE, 2025
Average monthly gross wage by professions and economic activities, 2025



TAB. 1.1

FORCA E PUNËS SIPAS ARSIMIT, MOSHËS DHE GJINISË*Labour force by education, age and sex*

(numër - number)

Niveli arsimor Educational level	Grup-mosha Age-group	Gjithsej - Total		Meshkuj - Men		Femra- Women	
		2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej Total	Total (15 +)	1.287.099	1.279.906	696.279	693.634	590.820	586.272
	15-64	1.166.957	1.148.661	623.172	613.877	543.785	534.784
	20-64	1.143.627	1.127.543	607.917	600.021	535.710	527.522
	15-24	110.459	101.324	67.144	61.389	43.315	39.935
	25-29	121.923	112.789	62.245	61.434	59.678	51.356
	25-54	779.077	762.611	401.375	396.464	377.702	366.147
	55-64	277.421	284.726	154.654	156.024	122.767	128.702
